



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Franga e Prishtinës MeQana 30.09.2014

Nr. i Organiit Org.broj	Numri i Broj	Shkronja Prenj	Vlera Vendosje
01-013/1359			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika g shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 2.3 dhe 8 të Ligjit nr 03/L 049 për financat e pushtetit lokal dhe nenit 35.2 pika g) të Statutit të Komunës se Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 29.09.2014, aprovon këtë:

V E N D I M
PËR PEZULLIMIN E PËRKOHËSHËM TË NENIT 21 DHE NENIT 13 PIKA 13.6
TË RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1

Me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vitisë, Kuvendi i Komunës së Vitisë aprovon Vendim për lirim nga pagesa e taksës komunale për të gjitha subjektet afariste të Komunës së Vitisë të parapara në nenin 21 dhe nenit 13 pika 13.6 të Rregullores komunale për taksa ngarkesa dhe gjoja duke filluar prej 01.01.2015 deri më 31.12.2015.

Neni 2

Obligimet e pa paguara të subjekteve afariste sipas nenit 21 të Rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoja deri më 31.12.2011 nuk shlyhen por pezullohen për pagesë deri më 31.12.2015.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Financa
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

